

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	FOTOT: Vijon në Tiranë konferenca shkencore ndërkombëtare “Kalimi i kufirit Shqipëri–Kosovë (Jugoslla vi) gjatë viteve 1944–1991: Analizë dypalëshe e dimensionit politik dhe njerëzor”
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/fotot-vijon-ne-tirane-konferenca-shkencore-nderkombet-are-kalimi-i-kufiri-i586262
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 12:41:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:37:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	977d5153a5e37c2a57b5e445e8aa656ba8fc28e5cfd1787ed1217b1bc168589
TEKSTI	0d89e39548d54722989d4dcab92518acf8a3dbae5e2732b11b8c7af1a20b7c3b
PAMJA	a44db00e3b63014a15e3042a4ed1a1c52770f6474709a062cabafb1165f3d6ab

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	063c196d03b4b4441adc08655b0971f097589279925b558c0026001b9d4c0b93
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/063c196d03b4b4441adc08655b0971f097589279925b558c0026001b9d4c0b93>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)



English



ie [FOTOT: Vijon në Tiranë konferenca shkencore ndërkombëtare "Kalimi i kufirit Shqipëri-Kosovë \(Jugosllavi\) gjatë viteve 1944-1991: Analizë dypalëshe e dimensionit politik dhe njerëzor"](#)

FOTOT: Vijon në Tiranë konferenca shkencore ndërkombëtare “Kalimi i kufirit Shqipëri-Kosovë (Jugosllavi) gjatë viteve 1944–1991: Analizë dypalëshe e dimensionit politik dhe njerëzor”



15 Shtator 2026, 14:37Kulturë TEMA



NJË POPULL NË DY ANËT E KUFIRIT: VIKTIMAT DHE FAMILJET E NDARA NGA DY REGJIME KOMUNISTE

Tiranë, 15 shtator 2026 – Po vijon në Tiranë konferenca shkencore ndërkombëtare “Kalimi i kufirit Shqipëri-Kosovë (Jugosllavi) gjatë viteve 1944–1991: Analizë dypalëshe e dimensionit politik dhe njerëzor”, ku studiues nga Shqipëria dhe Kosova po ballafaqojnë dokumente arkivore, burime diplomatike dhe dëshmi personale mbi pasojat politike dhe njerëzore të një kufiri që nuk ndau dy popuj, por shqiptarët në të dyja anët e tij.

Dy shtetet nuk ishin në luftë, por për njeriun që tentonte të kalonte kufirin, ajo vijë funksiononte si front lufte. Të vrarë, të plagosur, të burgosur, të internuar e të zhdukur, por edhe familje të ndara për dekada, të survejuara dhe të stigmatizuara – ky është dimension i njerëzor që po vendoset në qendër të diskutimeve.

Konferencën e hapi Dr. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, e cila e vendosi në qendër pikërisht njeriun dhe familjen e ndarë nga kufiri.

Duke sjellë historinë e gjyshes së saj, Refikës, dhe motrës së saj të martuar në Pejë, të cilat, megjithëse të afërta gjeografikisht, u takuan vetëm një herë në disa dekada, Sula solli përvojën e shumë familjeve shqiptare për të cilat kufiri e ktheu takimin familjar në privilegj dhe udhëtimin në objekt dyshimi.

“Dhuna e kufirit matet edhe me takimet që nuk ndodhën, familjet që u ndanë dhe njerëzit që, për dekada, pritën dikë të vinte nga ana tjetër”, nënvizoi Kryetarja e AIDSSH-së. Mesazhi i saj ishte se hapja dhe ballafaqimi i arkivave duhet të shërbejnë për të emërtuar viktimat dhe për t'i rikthyer historisë përvojën e familjeve.

Në vijim, Prof. Dr. Naim Berisha, Drejtor Ekzekutiv i Këshillit Shkencor të Institutit

Albanologjik të Prishtinës, vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të Tiranës dhe Prishtinës dhe nevojën për thellimin e tij përmes kërkimit të përbashkët. Ai u ndal vecanërisht te rëndësia e studimit të kufirit Shqipëri-Kosovë. Jo vetëm si vijë politike dhe territoriale, por si një hapësirë që ndikoi

drejtpërdrejt në jetën dhe marrëdhëniet e shqiptarëve në të dyja anët.
Prof. Dr. Teuta Shala-Peli, Drejtoreshë e Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, vlerësoi gjithashtu bashkëpunimin e krijuar me Autoritetin e Dosjeve dhe perspektivën për ta thelluar atë më tej, veçanërisht në fushën e studimit dhe kërkimit shkencor.

Ballafaqimi i burimeve të ruajtura në Tiranë dhe Prishtinë krijon mundësi për të plotësuar boshllëqe dhe për të ndërtuar një histori më të plotë të marrëdhënieve dhe përvojave në të dyja anët e kufirit.

Në punimin e saj tematik, Dr. Gentiana Sula u ndal te dallimi thelbësor ndërmjet rrjetit sekret të ngritur nga një diktaturë për kontrollin e shoqërisë dhe funksionimit të shërbimeve informative në një shtet demokratik, duke e vendosur dokumentacionin e ish-Sigurimit në kontekstin e mekanizmave të survejimit dhe represionit të regjimit.

Z. Altin Hoxha, anëtar i Autoritetit, solli më tej një analizë të strukturës dhe përmasës së arkivit të ish-Sigurimit të Shtetit. Punimi i tij argumenton se dokumentet nuk mund të interpretohen të shkëputura nga institucionet që i prodhuan dhe nga mënyra se si funksiononte vetë aparati i Sigurimit.

Analiza e paraqitur nga Hoxha evidenton një të dhënë me rëndësi për studimin e këtij arkivi: dokumentacioni i ish-Sigurimit të Shtetit i identifikuar dhe evidentuar deri më sot arrin në 7.339.347 fletë arkivore.

Prej tyre, 5.079.044 fletë, ose 69,2%, kanë si burim SHISH; 2.240.958 fletë, ose 30,53%, Ministrinë e Brendshme; dhe 19.345 fletë, ose 0,26%, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.
Por një nga përfundimet me rëndësi të punimit është se 7,3 milionë fletë e identifikua nuk mund të konsiderohen automatikisht si i gjithë dokumentacioni i krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit.
8.000 Fragmentimi institucional dhe lëvizja e dokumentacionit pas vitit 1991 e bëjnë të domosdoshëm rikompozimin e kontekstit të arkivit. Sipas punimit, vlera e tij nuk matet vetëm me numrin e dosjeve apo fletëve të ruajtura, por edhe me aftësinë për të rindërtuar marrëdhënien ndërmjet dokumentit, strukturës që e prodhoi dhe historisë që ai dëshmon.

Në këtë proces kërkimor një burim i rëndësishëm është edhe “Fondi Kosova”, i hapur nga AIDSSH për studiuesit në vitin 2025, me 11.630 fashikuj. Drejtoria e Arkivit ka evidentuar, ndër të tjera, 2.171 faqe mbi demonstratat e viteve 1981–1982, raportimet nga Beogradi dhe zhvillimet politike në Kosovë. Fondi ruan gjithashtu dokumente mbi arrestimet, dhunën dhe torturat ndaj shqiptarëve, shpërnguljet e detyruara dhe forma të tjera të represionit shtetëror.
Dy panelet e para të konferencës tashmë janë përmbyllur, me diskutime mbi kufirin si mekanizëm politik, ideologjik dhe biopolitik, marrëdhëniet Shqipëri–Kosovë/Jugosllavi, dokumentet arkivore, historiografinë, kujtesën dhe edukimin e brezave të rinj.

Konferenca po vijon me panelin e tretë, “Individët ndërmjet dy regjimeve”, ku në qendër vendosen përndjekja dhe përvoja njerëzore: nga rasti i albanologut Selman Riza dhe emigracioni politik jugosllav, te dëshmia e ish-të burgosurit politik Nestor Topençarov dhe kujtesa e banorëve të zonave kufitare.

Në sfond të diskutimeve mbetet një çështje ende e hapur: Kush ishin personat e vrarë, të plagosur, të arrestuar, të dënuar apo të zhdukur gjatë kalimit të segmentit kufitar Shqipëri–Kosovë? Ku u varrosën dhe çfarë dokumentesh ruhen për ta në Tiranë, Prishtinë dhe Beograd.@
Ballafaqimi i arkivave, dokumenteve dhe dëshmime familjare synon pikërisht këtë: që dokumentit t’i rikthehet emri dhe emrit historia njerëzore.

Konferenca vijon me kumtesat dhe diskutimet e panelit të tretë. A.K./TemA

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Ekspozita "Liri në hapësirë": Kur arti del nga korniza

14:01 Kulturë

[Celine Dion "pushton" Parisin](#)

12:56 Kulturë

[Kush ishte Flora Brovina? Gruaja që e ktheu dhimbjen në poezi, mjekësi dhe qëndresë](#)

12:16 Kulturë / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.